



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-106

Prishtinë, më 21 prill 2013, në orën 19:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 21 PRILL 2013

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca dhe Petar Miletiq, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Liburn Aliu, Ardian Gjini, Myzejene Selmani, Sasha Milosavleviq dhe Myfera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Skender Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Emrush Haxhiu, Sali Rexhepi, Xheladin Hoxha dhe Sherif Konjufca;

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me pikën e vetme të rendit të ditës:

- **Kërkesa e kryeministrit të Republikës së Kosovës për seancë të jashtëzakonshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës**

Kryetari i njoftoi nënkryetarët e Kuvendit dhe kryetarët e grupeve parlamentare se kryeministri i Kosovës, z. Hashim Thaçi, në pajtim me nenin 69, paragrafi 4 të Kushtetutës ka parashtruar kërkesë për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme më 21 prill 2013, në orën 20:00, për të raportuar për Marrëveshjen për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë, e cila është parafuar më 19 prill 2013, nga kryeministri i Republikës së Kosovës dhe kryeministri i Republikës së Serbisë.

Shkresat përcjellëse për marrëveshje janë proceduar sot, më 21 prill 2013, nga Zyra e Kryeministrit, përkatësisht nga sekretari i ZKM-së në emër të sekretarit të Kuvendit, që nuk është një rrugë e komunikimit ndërmjet institucioneve.

Kryetari e hapi diskutimin lidhur me kërkesën e kryeministrit të Kosovës për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme.

Lidhur me kërkesën e kryeministrit për të mbajtur seancë të jashtëzakonshme diskutuan: kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, nënkryetarët e Kuvendit: Sabri Hamiti dhe Xhavit Haliti, si dhe Adem Grabovci dhe Ismet Beqiri, kryetarë të grupeve parlamentare, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Nënkryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, ishte kundër mbajtjes së seancës së jashtëzakonshme.

Pas këtyre diskutimeve, Kryesia e Kuvendit, me pajtimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi së Kuvendi të mbajë seancë të jashtëzakonshme sot, e diel, më 21 prill 2013, me fillim në orën 20:00, me këtë

Rend dite

- Raportimi i kryeministrit të Republikës së Kosovës në Kuvendin e Republikës së Kosovës për Marrëveshjen për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë, e cila është parafuar më 19 prill 2013 nga kryeministri i Republikës së Kosovës dhe kryeministri i Republikës së Serbisë.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 19:30 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale